

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Eiffel Construction ” shpk**

Ne Tirane, sot me date 05 Gusht 2024 (dymije e njezete e Kater).

Ortaku I vetem themelues:

**Z.Arlind Mici** I datelindjes 11/06/1988, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptare madhor, me zotesi juridike për të vepruar identifikuar me karte identiteti me numer ID I80611111S, me cilesine e “Ortakut themelues” kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,FiskaleTatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “**Eiffel Construction**

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

**“Eiffel Construction” shpk**

Eshte person juridik I te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj Shoqeria “**Eiffel Construction” shpk**, eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasi shqiptare **Z. Arlind Mici** I cili pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka seline në Tirane Rruga Nexho Konomi objekt me nr pasurie 306/414+3-22 dhe zone kadastrale 3866 Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqiperisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

.

.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarise**

Aktivitete te projektimit, arkitekturor, interier dhe te gjitha llojet e veprimtarise qe lidhen mearkitekturen. Studime Hidrologjike;Gjeologjike; Analiza

Gjeoteknike; Matje Studime Gjeofizike, Sizmike; Rilevimetopografike, Plan Biznesi; Projektim Front-End (FEED) Llogaritje dhe Analiza; Projekti i Detajuar; Elektrik; Zbatimit; arkitekturor për banesat rezidenciale; arkit.r për ndërtesaturistike; objekte sportive; qendra tregtare, socio-kulturore; ndërtesa fetare; ndërtesaarsimi; qendra shëndetësore; terminale dhe infrastrukturë; struktura speciale; hapësirave të jashtme, menaxhimi i hapësirave të gjelbra, zhvillimi i parqeve .Interior Design; planifikim Urban Projektim i Peizazhit; Politikat dhe Strategjitë e Planifikimit; Studime Urbanistike Industriale dhe Ekonomike; ?Studime Urbanistike Turistike; Plane të Përgjithshme lokale (Ndërlokale); Masterplane; supervizim, Zhvillim i një Plani të Menaxhimit të Cilësisë së Projektit; Administrim të punëve civile; Mbikëqyrja e ekzekutimit të punimeve; Matjet në terren të punimeve; Testimi procedurat e terrenit; Inspektim dhe vlerësim i pajisjeve; Kryerja e testeve/kontrollove të pavarura; Skedulimi; Mbikëqyrja e çdo lloj instalimi mekanik dhe elektrik; Shërbimet e Auditimit të Mjedisit; Monitorimi i zbatimit të ESMP; Inspektimi i HSE; Rishikimi i dokumentacionit; Inspektimi i materialeve dhe cilësisë së punimeve; Miratimi i Nënkontraktimit të çdopjese të punës, Zgjatjes së kohës së mbarimit të punimeve, Materialeve dhe cilësisë së punëve, Vizatimeve të punëve të ndërtimit , Programit të punëve dhe burimit të materialeve, Vlerësim pasurish , Aktqendrueshmerie, Kolaudim, Eficence energjie: Raport auditimi në ndërtesa paraprake dhe përfundimtare, Menaxhim energjie dhe konsulence për shfrytëzim të energjisë në mënyrë optimale, konsultime me publikun, plane mobiliteti, aktivitete që lidhen me mobilitetin , siguri rrugore, për sigurinë rrugore, organizime në panairë në fusha të ndryshme, M.kz, ndërmjetes për shitblerjen, dhenien e marrjen me qira dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme, montimet e konstruksionet metalike si dhe cdo ndërtim tjetër i cili në përfundim, përben send të paluajtshëm. Projektimin dhe instalimin e sistemeve të sigurisë, Projektim dhe instalim në fushën e telekomunikacioneve mjeteve të sistemit vrojtues, sinjalizues audioviziv, mjeteve të mbrojtjes kundër zjarrit, pajisjeve të ndërlidhjes të teknikave të tjera të lejuara nga legjislacioni, instalimin dhe tregtimin e filmit të sigurisë së xhamit si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e pajisjeve të telekomunikacionit, radio komunikacionit dhe sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distancë të automjeteve etj. Studim fizibiliteti, për ndërtim të impianteve fotovoltaike dhe ndërtim të impianteve fotovoltaike. Projektimet të gjitha llojeve, rikonstruksione, restaurime, ndërtimet të gjitha llojeve, Real estate me të gjithë elementet esaj. Blerje dhe shitje mallrash, Shërbime konsulence të ndryshme, Punime hidraulike, hidrike dhe instalimesh të të gjitha llojeve. Çdo veprim tjetër financiar e tregtar që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### .Neni 5

### Kohezagjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## KREU II

### Kapitali

### Neni 6

### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100.000 (njqind mije) leke, i nenshkruar plotesisht nga ortaku vetem themelues ne masen 100%. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te kapitalit themeltar te shoqerise.

## **Neni 7** **Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit tenje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdomenyretjeterteparashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## **KREU II** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8** **Organi Vendimmarres**

Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise.Ortaku i vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimindheshkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

### **Neni 9**

#### **Administrimi**

Administrator i shoqerise “**Eiffel Construction**” , caktohet **Z.Arind Mici** ,i cili emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertitje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem themelues te shoqerise.

### **Neni 10**

#### **Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur

shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratoret, së bashku edhe vecas njëri tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratoret e përfaqësojnë Shqipërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratoret kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie më të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratoret angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet më të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të treta kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **Neni 11** **Viti Financiar**

Viti Financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i përfundimit fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet në 31 dhjetor.

### **Neni 12**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohe zgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast Asambleja merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "shoqëri në likuidim të siper".

### **Neni 13** **Bazaligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Përsa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërit tregtare", Kodin Civil dhe çfarë do ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

### **Neni 14** **Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti I mesipër pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues I shoqërisë tregtare Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale .

**ORTAKUI VETEM THEMELUES  
SHTETASI SHQIPETAR  
ARLIND MICI**